

NJOFTIM
Nr. 1300, datë 6.6.2022

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHETI

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”; dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, bën publik njoftimin, si më poshtë:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse, që janë të interesuara të aplikojnë për të marrë autorizim nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar ndihmën juridike parësore, duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Procedura dhe dërgimi i dokumentacionit

Kujdes! Dokumentacioni duhet të jetë në format *origjinal ose i njësuar me origjinalin, si dhe i përditësuar.*

Dokumentacioni që duhet të depozitojnë organizatat jofitimprurëse (OJF), për aplikim, për marrjen e autorizimit që lëshohet nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:

- a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
 - b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridike;
 - c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tre) vjet të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:
 - i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tre) vjetëve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;
 - ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare të nënshkruara nga ekspert kontabël i miratuar;
 - iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte;
 - iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;
 - ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
 - d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
 - dh) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;
 - e) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv;
 - f) adresën elektronike të komunikimit;
 - g) Numri unik i identifikimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Mungesa e numrit unik nuk është shkak për skualifikim, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër që nga implementimi i ligjit dhe vonesat në zbatimin e tij.*)
- Aplikimi për autorizim, i shoqëruar me dokumentacionin e sipërpërmendur, dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në adresën: *rruga “Jordan Misja”, godina nr. 3, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë*, brenda datës **17.7.2022**.

Aplikimet e paraqitura jashtë afatit nuk kualifikohen.